

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"2BM Group" SHPK**

Tiranë më datë 18.03.2022

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Ortaku i Vetëm Themelues i Shoqërisë:

1. Klajd Biberaj, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05.05.1991, lindur Bajram Curri, Tropojë, dhe banues në Njësia Administrative nr. 5, Rruga Zef Jubani, Nd. 15, Ap. 50, Tiranë, me numër personal J10505078C.

mbledhur sot më datë 18.03.2022

VENDOSI

Të krijojë një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim hartojë dhe miratojë këtë Akt Themelimi të Shoqërisë si më poshtë vijon:

Neni 1

Emërtimi

- 1.1 Emërtimi i Shoqërisë është "2BM Group" SHPK ndjekur pandashmërisht nga prapashtesa SHPK, e cila përfaqëson formën ligjore të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.
- 1.2 "2BM Group" SHPK do të ketë logon dhe vulën e saj, e cila miratohet nga Ortaku i vetëm i Shoqërisë.

Neni 2

Forma ligjore

- 2.1 Shoqëria është një person juridik shqiptar, e cila ka formën juridike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil në fuqi, Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.

Neni 3

Objekti

- 3.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:
 - Ofrimi i shërbimeve në marketing dixhital;
 - Tele-marketing;
 - Reklamim dhe menaxhim i rrjeteve sociale;
 - Ndërtim dhe menaxhim të website-ve;
 - Analistike dhe konsultim.
- 3.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet në përputhje me dispozitat ligjore, të zbatueshme me vendim të ortakut të vetëm / Asamblesë së Ortakëve.



Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.
- 4.2 Vendosija e mëpasshme e një kufizimi në kohë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 5

Selia

- 5.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: "Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, Pallati nr. 68, Kati 2, Zyra nr. 3, Tiranë".
- 5.2 Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë këtij territori, duke hapur zyra apo degë ose nëpërmjet veprimtarive të kryera në përputhje me misionin dhe statutin e Shoqërisë, si dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është në vlerën 5000 Euro e përbërë një kuotë e vetme.
- 6.2 Ortaku i zotërimit të kuotës është:
 - Klajd Biberaj, me numër identifikimi J10505078C, në cilësinë e ortakut të vetëm të Shoqërisë, që përbën 100% të kuotës të kapitalit themeltar të shoqërisë me vlerë të përgjithshme 5000 Euro (pesëmijë Euro).

Neni 7

Transferimi i pjesëve të kapitalit

- 7.1 Kuota e kapitalit të Shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej saj mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar më ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët.
- 7.3 Miratimi për transferimin e kuotës bëhet nga me Vendim Ortakut të vetëm të Shoqërisë / Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve

Neni 8

Organi vendimmarrës

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme me Ortak të vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë (në vazhdim Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve).
- 8.2 Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të Statutit në përputhje me dispozitat ligjore.
- 8.3 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;



- b) ndryshimet e Statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit/ve;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesit/ve dhe te ekspertit/ëve kontabël;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën "c" e "d" të pikës 9.3 të Statutit;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- gj) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) riorganizimin, falimentimin, likuidimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
- l) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti dhe të cilat nuk janë kompetencë e administratorit/ëve.

8.4 Çdo ndryshim Statuti duhet të depozitohet në QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

Neni 9

Kuorumi

9.1 Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ose të autorizuarit e tyre të posaçëm.

Neni 10

Administrimi

10.1 Asambleja e Përgjithshme emëron 1 (një) Administrator të Shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

10.2 Administratori i Shoqërisë, do të jetë:

Klajd Biberaj, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05.05.1991, lindur Bajram Curri, Tropojë, dhe banues në Njësia Administrative nr. 5, Rruga Zef Jubani, Nd. 15, Ap. 50, Tiranë, me numër personal J10505078C.

10.3 Administratori ka të gjitha kompetencat si një organ ekzekutiv i shoqërisë për të vepruar në marrëdhënie më të tretët në emër të Shoqërisë, në të gjitha rrethanat e lejuara nga statuti dhe ligji i zbatueshëm.

Neni 11

Përgjegjësitë e Administratorit

11.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit "Për Tregtarët e Shoqëritë Tregtare" Administratori detyrohet:

- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në Statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë veprimtarisë së Shoqërisë në mjedisin tregtar dhe përkatës;
- të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në Statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të Shoqërisë;
- të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm, siç kërkohet në dispozitat ligjore të zbatueshme.
- të sigurojë zbatimin e legjislacionit në fuqi për shoqëritë.



Neni 12

Viti Financiar

- 12.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon në 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor të vitit përkatës.

Neni 13

Mosmarrëveshjet

- 13.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti dhe funksionimin e Shoqërisë, palët i drejtohen legjislacionit shqiptar dhe synojnë zgjidhjen me mirëkuptim. Në rast të kundërt për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Statut hartohet në 4 (katër) ekzemplarë originalë në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

KLAJD BIBERAJ

Klajd Biberaj

